

# Manuali i përdorimit

Regjistrimi si individ dhe nënshkrimi elektronik

## 1. Hyrje

- **Cka është rTrust?**

rTrust është autoritet certifikues për lëshimin e nënshkrimit elektronik, vulës elektronike, certifikatës elektronike, identitetit digjital për qytetarë, biznese dhe ueb server, konform kornizës ligjore në fuqi në vendin tonë si dhe eIDAS Rregullores 910/2014 të BE-së, e cila përcakton standartet për shërbimet e besueshme elektronike.

- **Qellimi i manualit**

Ky manual është krijuar për të udhëhequr individët përmes procesit të regjistrimit në platformën tonë dhe për të ndihmuar në procesin e aplikimit për një vulë elektronike.

Duke ndjekur këtë udhëzues hap pas hapi, do të jeni në gjendje të:

1. **Regjistroheni si përdorues:** Kuptoni hapat e nevojshëm dhe informacionin e kërkuar për të krijuar me sukses një llogari DUO në platformën rTrust.
2. **Aplikoni për identitetin digjital dhe nënshkrim elektronik.**

Ky manual synon t'i bëjë proceset e regjistrimit dhe aplikimit sa më thjeshtë që të jetë e mundur, duke siguruar që ju të mund të krijoni identitetin tuaj digjital shpejt dhe lehtë brenda platformës tonë dhe të përfitoni nga nënshkrimi elektronik për nevojat tuaja vetanake.

Nëse hasni ndonjë problem ose keni nevojë për ndihmë të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni ekipin tonë të mbështetjes duke përdorur informacionin e dhënë në fund të këtij manuali.

## 2. Procesi i regjistrimit hap pas hapi

- **Hapi 1: Qasja në platformë.**

Për të hyrë në Platformë, duhet të përdorni url-në e mëposhtme nga një shfletues në një kompjuter personal ose një pajisje celulare (tablet ose smartphone): <https://rtrust.org>




Figura 1. Faqja kryesore

- **Hapi 2:** Mbani kursoren mbi opsionin **Zgjidhjet** dhe klikoni shërbimin e dëshiruar.




Figura 2. Zgjidhja e shërbimit të dëshiruar

- **Hapi 3:** Pasi klikoni në **Qytetarë** ju shfaqet një dritare e re në të cilën është mundësia të aplikoni për pakon DUO, duke klikuar në butonin **Apliko falas**.




Figura 3. Aplikimi për DUO

- **Hapi 4:** Plotësoni të gjitha informatat e kërkuara në këtë formë, të dhënat duhet të jenë reale. Pajtohuni me kushtet e kontratës dhe klikoni butonin **Vazhdo**.

Figura 4. Forma e aplikimit për DUO

- **Hapi 5:** Vazhdoni procesi e verifikimit përmes adresës tuaj elektronike, në të cilën do të pranoni një email nga rTrust. **Rekomandojmë që hapat e verifikimit të bëhen përmes pajisjes mobile** për arsye të verifikimit përmes kamerës.
- **Hapi 6:** Verifikoni email adresen tuaj duke klikuar në butonin **Verifiko emailin**.




Figura 6. Email nga ekipi i rTrust

- **Hapi 7:** Pas verifikimit të adresës suaj elektronike, ju shfaqet hapsira për skanimin e pjesës së përparme të ID-së tuaj.
- **Hapi 8:** Vazhdoni me skanimin e pjesës së pasme të ID-së tuaj.

Please scan back ID card



Loading. Please wait.



Figura 8. Forma për skenimin e ID-së

- **Hapi 9:** Poziciononi fytyrën tuaj në qendër dhe klikoni butonin **Start verification**.




Figura 9. Hapsira për skenimin e fytyrës tuaj

- **Hapi 10:** Prisni për verifikimin e të dhënave tuaja nga ekipi i rTrust. Pas verifikimit ju do të pranoni një email me vendimin për verifikimin e të dhënave.
- **Hapi 11:** Klikoni në linkun e bashkangjitur në email së bashku me vendimin e verifikimit të të dhënave.

**Decision of certificate application process**

Dear John,

We are delighted to inform you that your identity verification process has been successfully completed and approved! Congratulations on taking this important step in establishing your unique digital identity with us.

To proceed further, we kindly request you to create a strong and unique password for your digital certificate. This certificate will serve as a secure means to identify and authenticate yourself during various interactions within our system and beyond.

To complete this process and access your digital certificate, simply click on the link provided below:

<https://apply.rtrust.org/>

Once you've successfully set up your password, you can proceed to download the necessary manuals for the application, installation, and usage of certificates. Additionally, you will find software setup for electronic signature and advanced electronic seal at the following link: <https://rtrust.org/download>

Our team at rTrust is dedicated to provide a seamless experience for our users, and we are here to assist you through any part of the application procedure if needed. Should you encounter any questions or concerns, please do not hesitate to reach out to us.


We appreciate your cooperation and look forward to serving you with the utmost professionalism.

Best Regards,

rTrust Team

*Figura 11. Emaili nga ekpi i rTrust*

- **Hapi 12:** Plotësoni **fjalëkalimin** dhe hapsirën për **konfirmimin e fjalëkalimit** pastaj klikoni **Vazhdo**.



## Krijoni fjalëkalimin tuaj

Për të vazhduar, ju kërkohet të krijoni një fjalëkalim të sigurt për gjenerimin e certifikatës suaj eIDAS. Fjalëkalimi që vendosni në këtë fazë do të jetë i domosdoshëm për instalimin e certifikatës, nënshkrimin e dokumenteve në platformën e internetit rTrust dhe për të aksesuar platformat e partnerëve tanë.

**Shënim me rëndësi:** Ne nuk e ruajmë fjalëkalimin tuaj në sistemin tonë. Fjalëkalimi juaj nuk mund të ndryshohet ose përmirësohet në të ardhmen. Përgjegjësia për menaxhimin e fjalëkalimit bie tërësisht mbi ju. Prandaj, është e rëndësishme që ta ruani atë në një vend të sigurt. Ta keni parasysh se fjalëkalimi nuk mund të rikrijohet dhe duhet nisur përsëri procesin e aplikimit nga fillimi për certifikatë të re.

Ne e vlerësojmë besimin tuaj në rTrust dhe mezi presim t'ju shërbejmë.

Shkruani fjalëkalimin...

Konfirmo fjalëkalimin...

Vazhdo

Figura 12. Krijimi I fjalëkalimit

- **Hapi 13:** Urime, ju tani jeni të paisur me vule elektronike. Nëse dëshironi që instalimin e vules ta bëni edhe në paisjen tuaj elektronike, ju lutem ndiqni hapat që ju shfaqen në fotografi.

**Përgëzime!**

I/E nderuar John,

Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se certifikata juaj është krijuar me sukses. Tani mund të hyni në faqen tonë të internetit në <https://sign.rtrust.org/> për të nënshkruar dokumentet tuaja në mënyrë elektronike, të tilla si kontratat. Edhe pse instalimi i certifikatave nuk është i domosdoshëm, nëse vendosni t'i instaloni ato, ju lutemi ndiqni këta hapa:

1. Sigurohuni që kompjuteri juaj të ketë të instaluar softuerin RAR Extractor. Nëse nuk e keni të instaluar, mund ta shkarkoni dhe instaloni nga një burim i besuar.
2. Filloni procesin e shkarkimit të certifikatës duke klikuar [këtu](#)
3. Pasi të shkarkohet folderi i instaluesit të certifikatës, ekstrahojeni atë duke përdorur RAR Extractor. Më pas, thjesht klikoni dy herë mbi file-in e certifikatës dhe ndiqni hapat në dritaren që hapet derisa instalimi të përfundojë me sukses.
4. Certifikatat e instaluar janë të dukshme përmes skedarëve PDF, duke ju mundësuar të nënshkruani dokumente sipas zgjedhjes suaj. Kjo do të thotë që ju mund të nënshkruani kontrata ose dokumente pa pasur nevojë të përdorni portalin tonë.

Ne e vlerësojmë shumë besimin tuaj në rTrust dhe mezi presim t'ju shërbejmë.

Gjithë të mirat,

Ekipi rTrust

*Figura 13. Njofitmi nga ekipi i rTrust*

### 3. Informacioni i kontaktit për mbështetje

Email: [certificates@rtrust.org](mailto:certificates@rtrust.org)

Numri i telefonit: +383 49 247 857

### 3. Personi kontaktues për mbrojtjen e të dhënave personale

Endrina Ramadani

Email: [er@rtrust.org](mailto:er@rtrust.org)